

Nr 3151 pod  
Data 22.04.2016

## **SHPALLJE PËR SHPREHJE INTERESI**

**“Për regjistrimin e personave fizikë si administratorë ndërtesash”**

**BASHKIA ROSKOVEC**

**Prill 2016**

## **1. Kuadri ligjor**

Në përputhje me legjislacionin në fuqi, konkretisht Ligjin nr. 55/2025 "Për administrimin e bashkëpronësisë në ndërtesa", nuk parashikohen kriteret të mirëpërcaktuara dhe të detajuara si një listë e mbyllur për përzgjedhjen e administratorëve të ndërtesave. Ligji fokusohet kryesisht në rregullimin e procedurës së zgjedhjes, kompetencave dhe përgjegjësisë të administratorit, duke lënë në diskrecion të bashkëpronarëve, përmes asamblesë, përcaktimin e kriterëve konkrete sipas nevojave të tyre.

Aktet nënligjore të cilat përcaktojnë kriteret për përzgjedhjen e administratorëve të ndërtesave, bazuar në Ligjin nr. 55/2025 "Për administrimin e bashkëpronësisë në ndërtesa", nuk janë miratuar ende. Hartimi i këtyre akteve duhet të realizohet brenda një periudhe 1-vjeçare.

Në mungesë të akteve nënligjore të miratuara, kriteret për regjistrimin/përzgjedhjen e administratorëve të ndërtesave do të bazohen në Udhëzimin Nr. 2, datë 19.5.2015 "Për kushtet dhe procedurat për listimin dhe heqjen nga lista e administratorëve të ndërtesave, penaltetet dhe mbikëqyrja e veprimtarisë së tyre", përcaktohen kriteret dhe procedurat për regjistrimin e administratorëve në librin e administratorëve.

## **2. Kriteret për regjistrim**

Personat fizikë që shprehin interes për t'u regjistruar si administratorë ndërtesash duhet të plotësojnë këto kriteret:

- a) Të kenë moshë madhore dhe zotësi për të vepruar;
- b) Të mos jenë dënuar me vendim të formës së prerë për kryerjen e një vepre penale;
- c) Të kenë përfunduar, së paku, arsimin e mesëm të përgjithshëm ose profesional;

## **3. Kërkesa për regjistrim**

Për t'u regjistruar në librin e administratorëve, personat e interesuar duhet të paraqesin kërkesë pranë Bashkisë Roskovec, në juridiksionin e së cilës do të ushtrojnë veprimtarinë.

Kërkesa duhet të shoqërohet me dokumentacionin përkatës, në original ose kopje të njësuara me origjinalin.

#### **4. Dokumentacioni i kërkuar**

- a) Kërkesë për regjistrim
- b) Kopje e dokumentit të identifikimit;
- c) Vërtetim i gjendjes gjyqësore (nga e-Albania, jo më i vjetër se 3 muaj)
- d) Diplomë e arsimit të mesëm (e përgjithshme ose profesionale);

#### **5. Trajnimi i administratorëve**

Pas përzgjedhjes së administratorëve të ndërtesave që plotësojnë kriteret e përcaktuara, do të zhvillohet trajnim për certifikimin e tyre.

Trajnimi profesional fillestar dhe i vazhdueshëm i personave për kryerjen e veprimtarisë së administrimit kryhet nga institucione profesionale të licencuara sipas legjislacionit në fuqi.

**KRYETAR**

**Majlinda Bufi**

**NË MUNGESË DHE ME URDHËR**

**ZËVËNDËS KRYETAR**

**Maksim Goga**



## FORMAT I KËRKESËS PËR REGJISTRIM

**Drejtuar:** Bashkisë Roskovec

**Lënda:** Kërkesë për regjistrim si administrator ndërtesash

Unë i nënshkruari/a \_\_\_\_\_, lindur më \_\_\_/\_\_\_/\_\_\_\_, me nr. personal \_\_\_\_\_, banues në \_\_\_\_\_, paraqes kërkesën për t'u regjistruar në librin e administratorëve të ndërtesave pranë Bashkisë Roskovec.

Deklaroj se plotësoj kriteret ligjore për ushtrimin e kësaj veprimtarie dhe bashkëngjitur gjendet dokumentacioni përkatës në përputhje me kërkesat ligjore.

Jam i/e gatshëm/e të ndjek trajnimet e nevojshme dhe të përmbush detyrimet që rrjedhin nga legjislacioni në fuqi.

**Të dhënat e kontaktit:**

Telefon: \_\_\_\_\_

Email: \_\_\_\_\_

**Data:** \_\_\_/\_\_\_/\_\_\_\_

**Nënshkrimi:** \_\_\_\_\_